

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion nr. 880/3 Prot., datë 15.06.2021 në të cilën kërkon informacion në lidhje me pretendimet e ankuesit Z. Xheladin Peka, ju sqarojmë se:

Z. Peka përmes avokatit të tij Agron Gjedia i është drejtua Institutit të Sigurimeve Shoqërore me kërkesën e datës 10.02.2021, protokolluar pranë nesh me nr. 1098 Prot., datë 11.02.2021, duke kërkuar vënien në dispozicion të një kopje të njësuar me origjinalin, të shkresës së ISSH nr. 2431 Prot., datë 25.04.2008. Në vijim Instituti i Sigurimeve Shoqërore i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me shkresën nr. 1098/1 Prot., datë 22.02.2021, duke i kërkuar marrjen e masave për vënien në dispozicion të shkresës së kërkuar nga z. Peka.

Me kërkesën e datës 23.04.2021, protokolluar pranë nesh me nr. 1098/2 Prot., datë 26.04.2021, z. Peka përmes avokatit të tij Agron Gjedia i është drejtua sërish Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke kërkuar vënien në dispozicion të një kopje të njësuar me origjinalin, të shkresës së ISSH Nr. 2431 Prot. datë 25.04.2008. Në vijim Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën Nr. 1098/13 Prot. datë 30.04.2021 ka sqaruar Z. Peka, se i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për vënien në dispozicion të shkresës së kërkuar nga ana tij, duke qenë se shkresa e mësipërme administrohet pranë kësaj drejtorie së bashku me dosjen tij të pensionit.

Z. Peka i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt vënien në dispozicion të shkresës së mësipërme. Në këtë proces gjyqësor nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore është paraqitur si provë shkresa Nr. 2431 Prot. datë 25.04.2008. Aktualisht çështja është në shqyrtim pranë kësaj gjykate.

Bashkëlidhur:

- Kërkesa e datës 10.02.2021, protokolluar pranë nesh me nr. 1098 Prot. datë 11.02.2021,
- Kërkesën e datës e datës 23.04.2021, protokolluar pranë nesh me Nr. 1098/2 Prot. datë 26.04.2021,
- Shkresa Nr. 2431 Prot. datë 25.04.2008,
- Njoftim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë datë 28.05.2021.